



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 112
Datë: 28/01/2022

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë, bazuar në dispozitat e përcaktuara me nenin 173 pika 1, nenin 174 dhe nenin 178 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Rregullores nr. 191, dt. 16.2.2021, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, paragr. 1 të nenit 31 të Rregullores nr. 1/131, datë 1.6.2015 për punën e Senatit të UP-së dhe në bazë të veprimeve procedurale të rregulluara me nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit nr. 05/l-031 për Procedurën e përgjithshme administrative, në mbledhjen e mbajtur me datë 06.1.2022, nxjerr këtë:

KONKLUZION

- I. Për shkak të mos përmbylljes së procedurave vlerësuese për të gjithë kandidatët aplikues në pozitën nr. 10 dhe 29 të konkursit nr. 804, datë 14.5.2021, siç parashihet me Rregulloren nr. 191, datë 16.2.2021, konkursi përmbyllet pa mundur të zgjedhet asnjëri prej kandidatëve në dy pozitat e sipërshënuara.
- II. Me kërkesë të Këshillit të Fakultetit, pozitat për lëndët përkatëse mund të rishpallen në konkursin e radhës
- III. Ky konkluzion hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Senati i UP-së.

Arsyetim

1. Universiteti i Prishtinës, në kuadër të konkursit nr. 804, datë 14.05.2021 përveç pozitave tjera në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë ka shpallur edhe pozitën nr. 10 dhe nr. 29, respektivisht për lëndët si në vijim:
 10. Pesë mësindhënës për lëndët: Kirurgji (MP) (O), Kirurgji IV (St) (O), Kirurgjia me traumatologji II (Fizioterapi) (O), Ndihma e parë I (MP) (O), Ndihma e parë I (St) (O), Ndihma e parë II (Fizioterapi), Kirurgji V (MP) (O), Mjekësi urgjente V (MP) (O), Kirurgji VI (MP) (O), Infermiera kirurgjike dhe onkologjike II (Infermieri) (O), Abdomeni akut (MP) (Z); dhe
 29. Një asistent për lëndët: Kirurgji (MP) (O), Kirurgji (Stomatologji) (O), Kirurgji me traumatologji (Fizioterapi) (O), Ndihma e parë (MP) (O), Ndihma e parë (Stomatologji) (O), Ndihma e parë (Fizioterapi) (Z), Mjekësi urgjente (bashkë me anestezion) (O), Infermiera kirurgjike dhe onkologjike II (Infermieri) (O).

Për pozitën nr. 10, respektivisht për lëndët e sipërshënuara kanë aplikuar pesë (5) kandidatë, ndërsa për pozitën nr. 29, respektivisht për lëndët e sipërshënuara kanë aplikuar pesë (2) kandidatë.

Në bazë të Statutit të UP-së, kushteve të konkursit, udhëzimeve për procedurat që duhet të ndiqen nga njësitë akademike në lidhje me konkursin e sipërshënuar për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë, ka caktuar Komisionin recensues për dy pozitat e lartshënuara, mirëpo dy nga tre anëtarët e komisionit vlerësues janë dorëhequr për arsye të ndryshme. Në pamundësi që të emëroj komision tjetër për shkak të mungesës së kuadrit nga fusha përkatëse, me kërkesë të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë, Rektorati UP-së i ka bërë kërkesë Universitetit të Tiranës, për emërimin e dy mësindhënësve

të fushës përkatëse nga Fakulteti i Mjekësisë. Universiteti i Tiranës i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së Rektoratit të UP-së duke emëruar dy mësimdhënës për anëtarë të komisionit vlerësues.

Në këtë situatë komisioni është kompletuar me dy anëtarë nga Fakulteti i Mjekësisë së Universitetit të Tiranës dhe një anëtarë në cilësi të kryetarit të komisionit nga Fakulteti i Mjekësisë së UP-së.

Komisioni në përbërje të plotë ka qenë i obliguar që në afat prej 15 ditëve të dorëzoj raportin vlerësues për të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar në dy pozitat e sipërshënuara. Komisioni nuk kishte dorëzuar raport edhe pasi kishin kaluar rreth 40 ditë nga emërimi i tyre. Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë duke parë që Komisioni nuk ka dorëzuar raport vlerësues edhe pas një afati shtesë të dhënë komisionit, ka kërkuar përsëri nga Rektorati i UP-së mbështetje për të siguruar 2 mësimdhënës të fushës përkatëse në cilësinë e anëtarëve të komisionit vlerësues, nga Universitetet tjera me të cilat UP ka marrëveshje të bashkëpunimit.

Rektori i UP-së duke marr parasysh kërkesën e Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë, i është drejtuar me kërkesë rektorit të Universitetit të Trakia's në Turqi, për mundësinë e emërimit të dy mësimdhënësve në cilësi të anëtarëve të komisionit vlerësues. Universiteti i Trakia's i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së Rektoratit të UP-së duke emëruar dy mësimdhënës për anëtarë të komisionit vlerësues. Komisioni vlerësues pas pranimit të dokumentacionit të kandidatëve brenda afatit ka shkruar vlerësim vetëm për njërin prej kandidatëve aplikues në pozitën nr. 10, ndërsa jo edhe për kandidatët tjerë. Meqë për pozitën nr. 10 të konkursit parashihej emërimi i pesë (5) mësimdhënësve, rektori i UP-së pas diskutimit në Senat të kësaj çështje, kishte marrë aprovim që komisionit t'i jepet edhe një afat shtesë prej 10 ditësh në mënyrë që raporti recensues të përmbillet siç parashihet me rregulloren nr. 191, dt. 166.2.2021, pra duke vlerësuar dhe krahasuar të gjithë kandidatët aplikues. Edhe pas afatit shtesë komisioni vlerësues nuk kishte bërë ndonjë vlerësim tjetër, respektivisht nuk ka dorëzuar raport vlerësues të kompletuar.

Rektori i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 06. 01. 2022, duke pasur parasysh të gjitha konstatimet si më sipër dhe mungesën e propozimit të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë për zgjedhjen e kandidatit të vetëm të propozuar për pozitën nr. 10, vendosi që lidhur me këtë çështje të hap diskutim në Senat. Pas diskutimit nga ana e Senatit, u vendos si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur që ka qenë subjekt i këtij konkursi, kundër këtij vendimi ka të drejtë ankese tek Komisioni i Ankesave dhe Parashtrësave të Senatit të Universitetit në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të Universitetit;
2. Kandidatëve;
3. Dekanes së Fakultetit të Mjekësisë;
4. Zyrës ligjore në UP;
5. Zyrës për Çështje Akademike.



Prof. Dr. Gazmer Sahiti, rektor